

**Njoftim për përqendrimin me të cilin Salus promet s farmaceutskimi, medicinskimi in drugimi proizvodi d.d., Lubjanë, Slloveni,
do të fitojë kontrollin e vetëm mbi FARMEDICA Trgovsko podjetje d.o.o. Lubjanë, Slloveni**

(Lënda nr. 08-130/2026)

Në përputhje me nenin 15 të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr. 145/10, 136/11, 41/14, 53/16, 83/18 dhe „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“ nr. 208/24 dhe 16/25), më datë 03.09.2026, në Komisionin për Mbrojtjen e Konkurrencës është dorëzuar njoftim për përqendrim me të cilin **SALUS promet s farmaceutskimi, medicinskimi in drugimi proizvodi d.d., Ljubljana (SALUS promet s farmaceutskimi, medicinskimi in drugimi proizvodi d.d., Ljubljana)**, me seli të regjistruar në adresën Litostrojska cesta 46A, 1000 Lubjanë, Slloveni, do të fitojë kontrollin e vetëm mbi **FARMEDICA Trgovsko podjetje d.o.o. Ljubljana (FARMEDICA Trgovsko podjetje d.o.o. Ljubljana)**, me seli të regjistruar në adresën Leskoškova cesta 12, 1000 Lubjanë, Slloveni.

Pjesëmarrësit në përqendrim dhe aktivitetet e tyre afariste:

SALUS promet s farmaceutskimi, medicinskimi in drugimi proizvodi d.d. është shoqëria mëmë e grupit të shoqërive Salus („Grupi Salus“). Grupi Salus realizon pjesën më të madhe të të ardhurave të tij nëpërmjet shoqërive të tij të varura, SALUS, veletrgovina, d.o.o. („Salus VT“) dhe Sanolabor d.d. („Sanolabor“), aktivitetet kryesore të të cilave janë tregtia me shumicë (Salus VT dhe Sanolabor) dhe tregtia me pakicë (Sanolabor) e barnave, produkteve farmaceutike, pajisjeve mjekësore, pajisjeve dhe materialeve mjekësore. Shoqëritë në kuadër të Grupit Salus ofrojnë gjithashtu shërbime të magazinimit, shërbime në fushën e çështjeve rregullatore, shërbime në fushën e farmakovigjilencës, marketing dhe promovim farmaceutik, si dhe shërbime në fushën e farmakoekonomisë.

Në Republikën e Maqedonisë së Veriut, Grupi Salus është i pranishëm nëpërmjet shoqërisë së tij të varur – Shoqëria për tregti, përfaqësim dhe marketing CARSO PHARM SHPKNJP Ilinden („Carso NMAK“), me NUAS 7054963 dhe me adresë në rr. 34 nr. 5A, Ilinden, Republika e Maqedonisë së Veriut. Carso NMAK është aktive në përfaqësimin dhe marketingun e markave tregtare të prodhuesve kryesorë të produkteve farmaceutike, përkatësisht me veprimtari prioritare 74.990 – Veprimtari të tjera profesionale, shkencore dhe teknike, të papërmendura diku tjetër, si dhe me veprimtari tjetër 46.46 – Tregti me shumicë e produkteve farmaceutike (veprimtari në qarkullimin e brendshëm).

FARMEDICA Trgovsko podjetje d.o.o. është shoqëri me përgjegjësi të kufizuar dhe është aktive në shpërndarjen dhe furnizimin me produkte për vetëkujdesje në tregun slloven. Bazën e portofolit të shoqërisë e përbëjnë barnat për përdorim njerëzor që jepen pa recetë dhe pajisjet mjekësore, ndërsa suplementet ushqimore, produktet ushqimore dhe produktet e tjera përbëjnë pjesë plotësuese të asortimentit. Të ardhurat e Farmedica-s realizohen kryesisht nëpërmjet subjekteve të tregtisë me shumicë, të cilat furnizojnë kanalin e farmacive dhe të cilat marrin pjesë me rreth 94% të të ardhurave të shoqërisë, ndërsa në masë më të vogël nëpërmjet dyqaneve të specializuara. Farmedica nuk ka shoqëri të varura.

FARMEDICA Trgovsko podjetje d.o.o. nuk është aktive në Republikën e Maqedonisë së Veriut. Shoqëria nuk ka shoqëri të varura dhe as mjete në Republikën e Maqedonisë së Veriut dhe gjatë vitit 2025 nuk ka realizuar asnjë qarkullim në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Për qëllimet e vlerësimit të përqendrimit në fjalë, parashtruesi i njoftimit propozon që tregu përkatës të përkufizohet si tregu i tregtisë me shumicë të barnave për përdorim njerëzor që jepen pa recetë, tregu i tregtisë me shumicë të pajisjeve mjekësore dhe tregu i tregtisë me shumicë të produkteve të tjera (suplemente ushqimore, produkte kozmetike, produkte ushqimore etj.) në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Bazuar në shqyrtimin paraprak, Komisioni konstatoi se përqendrimi në fjalë mund të bjerë nën dispozitat Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës.. Megjithatë, vendimi përfundimtar lidhur me këtë çështje është rezervuar.

Komisioni i fton palët e treta të interesuara që të paraqesin vërejtjet dhe mendimet e tyre lidhur me këtë përqendrim pranë Komisionit. Vërejtjet dhe mendimet e palëve të treta të interesuara mund të dërgohen në adresën: rr. „Shën Kirili dhe Metodi“ nr. 54, Shkup, ose në e-mail: kzk@kzk.gov.mk dhe të njëjtat duhet të arrijnë në Komision brenda 10 ditëve nga dita e publikimit të këtij njoftimi.

09.09.2026

Shkup